



Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit

MEMORIA

Revistë studimore

Viti i dytë i botimit, nr. 2, 2022

Tiranë, 2022

REVISTA STUDIMORE “MEMORIA”
Botim i Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e
Komunizmit

Kryeredaktore:
Dr. Armanda Hysa

Redaktore letrare:
Violeta Murati

Bordi editorial:
Dr. Çelo Hoxha (ISKK)
Dr. Armanda Hysa (ISKK)
Dr. Hasan Bello (Institutit i Historisë, ASA)
Dr. Ardit Bido (AQSH)
Dr. Idriz Idrizi (IDMC)
Dr. Virion Graçi (Institutit i Gjuhësisë dhe Letërsisë, ASA)
Dr. Brisejda Lala (ISKK)
Ma. Kastriot Dervishi (AMPB)
Ma. Ergys Mertiri (ISKK)
Msc. Erald Kapri (AMA)

© Copyright ISKK, 2022

Design & Layout:
Grafika Elzana

ISSN: 2789-8911

Shtypur në Shtypshkronjën

Botuar në Tiranë,
Shqipëri

TRYEZA E LËNDËS

ARTIKUJ SHKENCORË

Dr. Klejd Këlliçi Në shtëpinë e ‘armikut’: Studentët shqiptarë në perëndim, 1970-1990	7
Dr. Bozhica Slavkoviç Miriq Mbi hulumtimin e marrëdhënieve ekonomike jugosllavo-shqiptre gjatë viteve 1945-48	32
Dr. Blerina Këllezi dhe Msc. Aurora Guxholli Pasojat e krimeve të komunizmit dhe rëndësia e reformave ekonomike në drejtësinë tranzitore	60
Msc. Florin Zyberaj Organizimi dhe detyrat e Divizionit të Mbrojtjes së Popullit (1944-1949)	83
Xhafer Sadiku Deformimi i historisë për të formuar shoqërinë socialiste dhe njeriun e ri.....	101
Msc. Lubjana Malaj Përndjekja, kontrolli dhe trajtimi çnjerëzor që i`u bë individit gjatë periudhes komuniste.....	123

KUJTESË DHE REFLEKTIM

Uran Butka Larg njerëzve.....	145
Lindita Arapi Ngrëhina e frikës: Diktatura ekziston si traumë e heshtur	157
VEPRIMTARIA E ISKK GJATË VITIT 2021	163

MBI HULUMTIMIN E MARRËDHËNIEVE EKONOMIKE JUGOSLLAVO-SHQIPTARE GJATË VITEVE 1945-48¹

Bozhica Slavković Mirić

Instituti i Historisë së re të Serbisë, Beograd

Abstrakt

Në punimin tonë, që ka të bëjë me hulumtimin e marrëdhënieve ekonomike jugosllavo-shqiptare 1945-1948, do të paraqesim se si e kemi analizuar këtë temë, do të përshkruajmë burimet që kemi përdorur dhe do të nxjerrim në pah përfundimet që kemi arritur. Marrëdhëniet mes dy vendeve ishin rënduar nga konfliktet e mëparshme të stërzgjatura dhe të kushtëzuara nga politikat e fuqive të mëdha në Gadishullin Ballkanik. Pavarësisht kësaj, komunistët jugosllavë dhe shqiptarë vendosën një marrëdhënie miqësore. Shqipëria po rimëkëmbej me ndihmën ekonomike jugosllave, veçanërisht në bujqësi, luftën e përbashkët kundër urisë dhe ndërtimin e hekurudhave dhe fabrikave. Po ashtu, Shqipëria kopjoi sistemin politik jugosllav. Në atë periudhë, dy vendet patën konflikt me fuqitë perëndimore dhe kishin nisur negociatat mes Jugosllavisë dhe Bullgarisë për krijimin e një federate ballkanike, në të cilën do të përfshihej edhe Shqipëria. Jugosllavia ndoqi shembullin

1 Ky artikull u shkrua në kuadër të punës si kërkuese shkencore pranë Institutit të Historisë së re të Serbisë, financuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Zhvillimit Teknologjik, bazuar në Marrëveshjen mbi Realizimin dhe Financimin e Kërkimit Shkencor NIO 2022 nr. 451-03-68 / 2022-14 / 200016, 4 shkurt 2022.

e sistemit shtetëror dhe partiak sovjetik dhe Stalini ia la Shqipërinë sferës së ndikimit jugosllav. Kulmi i bashkëpunimit mes Jugosllavisë dhe Shqipërisë ishte vizita e Enver Hoxhës në Jugosllavi, në mesin e vitit 1946, dhe nënshkrimi i Traktatit të Miqësisë, Bashkëpunimit dhe Ndihmës së Ndërsjellë. Megjithatë, kriza në marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare ndodhi kur krerët e partive sovjetike dhe shqiptare vendosën bashkëpunim të drejtpërdrejtë, me vizitën e Enver Hoxhës në Moskë në mesin e vitit 1947. Më në fund, bashkëpunimi me Jugosllavinë u pezullua kur u miratua rezoluta e Informbyrosë dhe Shqipëria mori anën e BRSS-s. Marrëdhëniet mes Jugosllavisë dhe Shqipërisë u normalizuan pas vitit 1955, por mosbesimi dhe distanca mbetën.

Fjalë kyçe: Shqipëri, Marrëdhënie ekonomike, Jugosllavi, Periudha pas Luftës së Dytë Botërore, BRSS.

Hyrje

Tema së cilës i kushtohet ky punim është trajtuar vetëm pjesërisht në literaturën historiografike kushtuar marrëdhënieve jugosllavo-shqiptare në periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore. Prandaj, ky hulumtim u ndërmor si përpjekje për të hedhur dritë mbi segmentin e marrëdhënieve ekonomike ndërmjet Jugosllavisë dhe Shqipërisë, në bazë të burimeve historike dhe literaturës profesionale në dispozicion. Theksi vihet në planet që janë bërë për realizimin e bashkëpunimit ekonomik ndërmjet këtyre dy vendeve dhe në realizimin e tyre nga viti 1945, deri në vitin 1948. Rezultatet e këtij hulumtimi i shkrova në temën e magjistraturës në Fakultetin Filozofik në Beograd me titull “Marrëdhëniet ekonomike jugosllavo-shqiptare 1945-1948. Planet dhe bashkëpunimi”, të cilën më pas e zgjerova dhe botiva si monografi në vitin 2020.²

Në punimin tonë do të trajtojmë mënyrën e hulumtimit të marrëdhënieve ekonomike jugosllavo-shqiptare 1945-1948, ku përfshihet evolimi i bashkëpunimit, shtrirja dhe lloji i tij, si dhe kushtet politike për krijimin e marrëdhënieve ekonomike. Më pas

² Božica Slavković Mirić, *Yugoslavia and Albania 1945-1948. Economic relations* (Beograd: Institut za noviju istoriju Srbije, 2020).

do të analizojmë burimet, literaturën dhe shtypin që kemi përdorur. Po ashtu do të paraqesim përfundimet kryesore që arritëm në këtë hulumtim. Qëllimi i këtij artikulli është të parashtrojë pyetje të reja, përgjigjet e të cilave do të zgjerohin analizën e dhënë dhe do të ngrinin tema të reja në kërkime të mëtejshme.

Burimet, studimet ekzistuese dhe qasja

Për hetimin e marrëdhënieve ekonomike jugosllavo-shqiptare 1945-1948 kemi përdorur metodën klasike historike, me studimin e burimeve sasiore, gjegjësisht të të dhënave statistikore dhe burimeve ekonomike. Me anë të analizës krahasuese të dy vendeve, jemi përpjekur të vëmë në dukje se si Shqipëria nisi të integrohej ekonomikisht me Jugosllavinë. Për këtë kemi përdorur materiale arkivore të botuara dhe të pabotuara. Për hulumtimin e marrëdhënieve jugosllavo-shqiptare para vitit 1945 kemi përdorur lëndë arkivore nga Arkivi i Jugosllavisë, Arkivi i Serbisë dhe Arkivi Ushtarak. Në pjesën më të madhe kemi përdorur materiale arkivore të pabotuara, kryesisht nga fondet e Arkivit të Jugosllavisë. Fondi i Zyrës së Marshallit të Jugosllavisë³përmban materiale për vizitat e delegacionit shqiptar, transkripte të bisedimeve dhe shënime për mesazhet e shkëmbyera nga shtetarët e rangut të lartë. Në të njëjtin fond gjetëm material për marrëdhëniet dhe bashkëpunimin mes Jugosllavisë dhe Shqipërisë, mbi bazën e të cilit mund të konkludojmë se sa ishte ndihma jugosllave për Shqipërinë dhe sa ishte e pranishme Jugosllavia në shtetin dhe politikën shqiptare. Fondi i Tanjugut⁴përmban buletinet e lajmeve nga agjencitë e huaja dhe vendase mbi marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare, praninë jugosllave në Shqipëri dhe rinovimin dhe zhvillimin e Shqipërisë falë ndihmës ekonomike jugosllave. Fondi që rezultoi si më i rëndësishmi për ne në përgatitjen e punimit është fondi i Komisionit për Marrëdhëniet Ndërkombëtare, në të cilin gjenden një sasi e madhe të dhënash për ndihmën e Jugosllavisë për Shqipërinë, ekspertët jugosllavë në këtë vend dhe raporte të përfaqësuesve jugosllavë.⁵Fondi

3 Arkivi i Jugosllavisë, Beograd, Republika e Serbisë (shkurt: AJ), Fondi 836, Zyra e Marshallit të Jugosllavisë.

4 AJ, Fondi 112, Agjencia e lakmeve Tanjug

5 AJ, Fondi 507/9, Komisioni për Lidhjet Ndërkombëtare të Komitetit Qendror të Ligës së Komunistëve të Jugosllavisë.

i Ministrisë Federale të Punës përmban të dhëna për emigracionin shqiptar, studentët dhe nxënësit shqiptarë në Jugosllavi.⁶Të dhënat për seancat, vendimet e rëndësishme dhe marrëdhëniet ndërkombëtare gjenden në fondet e Presidiumit të Kuvendit Popullor të Republikës Popullore Federative të Jugosllavisë dhe të Kryesisë së Këshillit të Ministrave.⁷

Materiali i pasur arkivor për marrëdhëniet mes Jugosllavisë dhe Shqipërisë gjendet edhe në Arkivin Diplomatik të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Serbisë, në fondin e Arkivit Politik.⁸ Aty gjetëm raporte diplomatike të përfaqësuesve jugosllavë në Shqipëri, rishikime dhe raporte të përmbledhura ekonomike, rishikime të situatës politike, shënime për bisedimet ndërmjet përfaqësuesve jugosllavë dhe udhëheqjes shqiptare, raporte të misioneve të huaja në Shqipëri, lista të pretendimeve ekonomike të shqiptarëve ndaj Jugosllavisë, propozime të përfaqësuesve jugosllavë për zgjidhjen e problemeve të ndryshme, telegramet e përfaqësuesve jugosllavë dhe raportet e të dërguarve tregtarë të Republikës Popullore Federative të Jugosllavisë në Shqipëri. Këto dosje përmbajnë edhe materiale për bashkëpunimin ushtarak, kulturor, arsimor dhe shëndetësor mes Jugosllavisë dhe Shqipërisë.

Për sa i përket materialit arkivor të botuar, koleksionet e dokumenteve janë veçanërisht të dobishme për çështje të rëndësishme shtetërore dhe marrëdhënie diplomatike.⁹ Traktatet e Jugosllavisë dhe Shqipërisë nga periudha që po hetojmë janë botuar në përmbledhjen “Balkanski ugovorni odnosi (Marrëdhëniet bashkëpunuese ballkanike - marrëveshjet)”.¹⁰ Disa materiale arkivore dhe të dhëna mbi ndihmën

6 AJ, Fondi 25, Ministria e Punës së RPFJ.

7 AJ, Fondi 15, Presidiumi i Asamblesë Kombëtare të RPFJ; Fondi 50, Kryesia e Këshillit të Ministrave të RPFJ.

8 Arkivat Diplomatike të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Serbisë, Beograd (shkurt: ADMPJRS), Arkivi Politik (shkurt: AP), 1945-1948, Shqipëria.

9 *Zapishnici sa sednica Politbiroa CK KPJ (11. jun 1945 – 7. jul 1948)*, red. Branko Petranović (Beograd: Arhiv Jugoslavije, Službeni list SRJ, 1995); *Jugoslavija 1918–1988. Tematska zbirka dokumenata*, red. Branko Petranović dhe Momčilo Zečević (Beograd: Rad, 1988); Branko Petranović dhe Momčilo Zečević, *Jugoslovenski federalizam – ideje i stvarnost: 1943–1986* (Beograd: Prosveta, 1987).

10 *Balkanski ugovorni odnosi: 1876–1996.: dvostrani i višestrani međunarodni ugovori i drugi diplomatski akti o državnim granicama, političkoj i vojnoj saradnji, verskim i etničkim manjinama*, II, (1919–1945), red. Momir Stojković (Beograd: Službeni list SRJ: Međunarodna politika, 1998); *Balkanski ugovorni odnosi: 1876–1996.: dvostrani i višestrani međunarodni ugovori i drugi*

e Jugosllavisë për Shqipërinë u botuan në përmbledhjen dokumentare “Bela knjiga o agresivnim postupcima vlada SSSR, Poljske, Čehoslovačke, Mađarske, Rumunije, Bugarske i Albanije prema Jugoslaviji (Libri i bardhë mbi qasjet agresive të qeverive sovjetike, polake, çekoslllovakë, hungareze, rumune, bullgare e shqiptare ndaj Jugosllavisë)¹¹. Për analizën e zhvillimit të planifikimit ekonomik jugosllav, janë të rëndësishme “Ekspozimet e Marshall Titos për politikën e jashtme jugosllave: mbajtur në seancën e përbashkët të Asamblesë Federale dhe Kuvendit Popullor më 1 prill 1946”¹² dhe “Ligji për planin pesëvjeçar të zhvillimit ekonomik të Republikës Popullore Federale të Jugosllavisë 1947–1951”¹³. Dokumentet arkivore sovjetike mbi bisedimet në nivelin më të lartë shtetëror dhe marrëdhëniet mes Jugosllavisë dhe BRSS, pra Shqipërisë, gjenden në koleksionet “Marrëdhëniet Jugosllavo-Sovjetike”. Informacione të dobishme statistikore na kanë dhënë: “Jugosllavia 1918–1988.”¹⁴ Vjetari statistikor dhe zhvillimi material dhe shoqëror i RSF Jugosllavisë 1947–1972”¹⁵ dhe Zhvillimi material e shoqëror i RSF të Jugosllavisë 1947–1972.”¹⁶

Studimi i çështjes së marrëdhënieve ekonomike jugosllavo-shqiptare përfshin edhe ditarë, kujtime dhe tekste origjinale të bashkëkohësve. Krijimi i bashkëpunimit ndërmjet komunistëve shqiptarë dhe jugosllavë gjatë luftës përshkruhet në ditarët e Dushan Mugoshës¹⁷

diplomatski akti o državnim granicama, političkoj i vojnoj saradnji, verskim i etničkim manjinama, III, (1946–1996), red. Momir Stojković (Beograd: Službeni list SRJ: Međunarodna politika, 1999).

11 *Bela knjiga o agresivnim postupcima vlada SSSR, Poljske, Čehoslovačke, Mađarske, Rumunije, Bugarske i Albanije prema Jugoslaviji* (Beograd: Ministarstvo inostranih poslova FNRJ, 1951); *Bela knjiga o neprijateljskoj politici Vlade Narodne Republike Albanije prema Federativnoj Narodnoj Republici Jugoslaviji* (Beograd: Državni sekretarijat za inostrane poslove Federativne Narodne Republike Jugoslavije, 1961).

12 *Ekspoze Maršala Tita o spoljnoj politici Jugoslavije: održan na zajedničkoj sednici Savezne skupštine i Skupštine naroda 1 aprila 1946* (Beograd, Zagreb: Kultura, 1946).

13 *Zakon o petogodišnjem planu razvitka narodne privrede Federativne Narodne Republike Jugoslavije: u godinama 1947–1951* (Beograd: Službeni list FNRJ, 1947).

14 *Jugoslovensko-sovjetski odnosi: 1945–1956*, red. Ljubodrag Dimić et al (Beograd: Ministarstvo spoljnih poslova, 2010); *Jugoslavija–SSSR. Susreti i razgovori na najvišem nivou rukovodilaca Jugoslavije i SSSR 1946–1964, I*, red. Lj. Dimić, L. A. Veličanskaja, T. A. Džalilov et al (Beograd: Arhiv Jugoslavije, 2014); *Napukli monolit. Jugoslavija i svet 1942–1948*, red. Ljubodrag Dimić dhe Aleksandar Životić (Beograd: Arhipelag, Službeni glasnik, 2012).

15 *Jugoslavija 1918–1988: statistički godišnjak* (Beograd: Savezni zavod za statistiku, 1989).

16 *Materijalni i društveni razvoj SFR Jugoslavije 1947–1972: Deseti kongres SKJ* (Beograd: Savezni zavod za statistiku, 1973).

17 Nijaz Dizdarević, *Albanski dnevnik* (Zagreb: Globus, Sarajevo: Oslobođenje, 1988).

dhe Nijaz Dizdareviqit.¹⁸ Zyrtarë të lartë shtetërorë të kohës, si Svetozar Vukmanoviq Tempo,¹⁹ Milovan Gjilas,²⁰ Edvard Kardelj,²¹ Boris Kidriç²² e Josip Smolaka,²³ në kujtimet e tyre iu referuan marrëdhënieve jugosllavo-shqiptare, ndihmës jugosllave për Shqipërinë, krizës dhe konfliktit mes dy vendeve, si dhe pikëpamjes sovjetike për marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare. Nga literatura shqiptare me kujtime, kemi shfrytëzuar të dhënat e liderit shqiptar Enver Hoxha, të cilat i paraqesin në mënyrë mjaft subjektive marrëdhëniet me Jugosllavinë.²⁴ Ka edhe kujtime të gjeneralit shqiptar Panajot Plaku, i cili thekson rëndësinë e ndihmës jugosllave për Shqipërinë dhe shprehet negativisht ndaj Enver Hoxhës dhe qeverisë së tij.²⁵

Në analizën e marrëdhënieve jugosllavo-shqiptare kemi shfrytëzuar edhe shtypin e pasluftës, në radhë të parë të përditshmet "Politika" dhe "Borba", të cilat kanë dhënë përmbledhje të ngjarjeve të rëndësishme në fushën e bashkëpunimit, marrëdhënieve dhe konflikteve ndërmjet dy vendeve, si dhe raporte dhe analiza për ndihmat jugosllave për Shqipërinë. Shkrimet e shtypit shqiptar ("Bashkimi", "Luftëtari", "Zëri i popullit"), sovjetik, italian, bullgar, grek, britanik dhe amerikan, i ndoqëm në bazë të transmetimit të teksteve të tyre në buletinet e Tanjugut.

Literatura profesionale që na ka ndihmuar për të përcjellë ngjarjet e përgjithshme politike dhe shoqërore në shtetin jugosllav, për t'i vendosur marrëdhëniet dhe situatën ekonomike në një kontekst të caktuar, është

18 Dušan Mugoša, *Na zadatku* (Beograd: Četvrti jul, 1975).

19 Svetozar Vukmanović-Tempo, *Zašto se i kako raspala Jugoslavija* (Beograd: Službeni list SRJ, 1996); Svetozar Vukmanović Tempo, *Revolucija koja teče. Memoari*, II (Zagreb: Globus, 1982).

20 Milovan Gjilas, *Heroj-antiheroj. Iskazi za istoriju* (Podgorica: Pobjeda, 2006); Milovan Gjilas, *Druženje sa Titom* (Šabac: Zaslona, 1990); Milovan Gjilas, *Vlast* (London: Naša reč, 1983); Milovan Gjilas, *Vlasti pobuna: memoari* (Zagreb: Europapress, Novi liber, 2009); Milovan Gjilas, *Razgovori sa Staljinom* (Beograd: Književne novine, 1990).

21 Edvard Kardelj, *Borba za priznanje i nezavisnost nove Jugoslavije: 1944.–1957 (sećanja)* (Beograd: Radnička štampa, Ljubljana: Državna založba Slovenije, 1980).

22 Boris Kidrič, *Izgradnja socijalističke ekonomike FNRJ*, III (Beograd: Kultura, 1960); Boris Kidrič, *Podaci reparacione komisije potvrđuju nepravdu koja se čini Jugoslaviji u pogledu reparacija*, III (Beograd: Komunist, 1960).

23 Josip Smolaka, *Partizanski dnevnik* (Zagreb: Spektar, 1986).

24 Enver Hodža, *Titoisti* (Tirana: Izdavačka kuća „8 nëntori“, 1982); Enver Hoxha, *Avec Staline: souvenirs* (Tirana: 8. Nëntori, 1979); Enver Hoxha, *The Anglo-American Threat to Albania: Memoirs of the National Liberation War* (Tirana: 8. Nëntori, 1982).

25 Panajot Pljaku, *Nasilje nad albanskom revolucijom* (Beograd: Narodna knjiga, Priština: Rilindija, Jedinstvo, 1984).

vendase.²⁶ Për studimin e shoqërisë agrare të Jugosllavisë, zhvillimit të saj industrial dhe ekonomik, rëndësi të veçantë patën monografitë dhe artikujt e Miodrag Nikoliqit dhe Bogdan Vidakoviqit,²⁷ Dushan Bilanxhiqit,²⁸ Ivana Dobrivojeviqit,²⁹ Momçilo Pavloviqit³⁰ dhe Nikola Zhivkoviqit.³¹ Libri i Jelena Rafailoviqit “Razvoj industrije na Balkanu – Zhvillimi i industrisë në Ballkan” ishte një udhërrëfyes i mirë për historinë ekonomike, si dhe për aplikimin e metodës krahasuese.³² Për ne ishin të dobishme edhe punimet e historianëve të rinj Srgjan Millosheviq, Milan Piljak, Aleksandar Rakonjac e Momir Ninkoviq për fushën e ekonomisë dhe ekonomisë së planit të Jugosllavisë. Nga brezi i ri, duam të veçojmë edhe Aleksandar V. Miletiqin dhe librat e tij për veprimtarinë e Millovan Gjilasit, politikanit që luajti një rol të rëndësishëm në periudhën në fjalë.³³

Monografitë e botuara menjëherë pas konfliktit ndërmjet Jugosllavisë dhe Byrosë Informative me qëllim paraqitjen e shtrirjes së ndihmës jugosllave për Shqipërinë u analizuan nga Vladimir Dedijer³⁴

26 Branko Petranović, *Istorija Jugoslavije 1918–1988*, III (Beograd: Nolit, 1988); Ljubodrag Dimić, *Istorija srpske državnosti. Srbija u Jugoslaviji*, III (Novi Sad: Srpska akademija nauka i umetnosti, 2001); Stevan K. Pavlović, *Srbija, istorija iza imena* (Beograd: Clio, 2004); Kosta Nikolić, *Srbija u Titovoj Jugoslaviji (1941–1980)* (Beograd: Zavod za udžbenike, 2011).

27 Miodrag Nikolić dhe Bogdan Vidaković, *Regionalni razvojproizvodnihsnagaJugoslavijeopoliticiSKJodPetogkongresa KPJdo Desetogkongresa SKJ* (Beograd: Savremenaadministracija, 1977).

28 Dušan Bilandžić, *Borba za samoupravni socijalizam u Jugoslaviji 1945–1969* (Zagreb: Institut za historiju radničkog pokreta Hrvatske, 1969); Dušan Bilandžić dhe Radovan Vukadinović, *Osnovne društvene promene u Jugoslaviji i svijetu nakon Drugog svjetskog rata 1945–1973* (Zagreb: Školska knjiga, 1973); Dušan Bilandžić, *Društveni razvoj socijalističke Jugoslavije* (Zagreb: Centar društvenih djelatnosti Saveza socijalističke omladine Hrvatske, 1976); Dušan Bilandžić, *Ideje i praksa društvenog razvoja Jugoslavije 1945–1973* (Beograd: Komunist, 1973); Dušan Bilandžić, *Kratak pregled razvitka društveno-ekonomskih odnosa u SFRJ 1945–1965* (Beograd: Centar za ideološko-političko obrazovanje Radničkog univerziteta “Đuro Salaj”, 1965).

29 Ivana Dobrivojević, *Selo i grad. Transformacija agrarnog društva Srbije 1945–1955* (Beograd: Institut za savremenu istoriju, 2013).

30 Momçilo Pavlović, *Srpsko selo 1945–1952. Otkup* (Beograd: Institut za savremenu istoriju, 1997).

31 Nikola Živković “StanjeujugoslovenskojprivredineposrednopozavršetkuDrugogsvetskograta” in *BalkanposleDrugogsvetskograta*, ed. PetarKačavenda (Beograd: Institutzasavremenuistoriju, 1996), 51-55.

32 Jelena Rafailović, *Razvoj industrije na Balkanu. Tekstilna industrija u Kraljevini Srba, Hrvata i Slovenaca i Bugarskoj 1919–1929* (Beograd: Institut za noviju istoriju Srbije, 2018).

33 Aleksandar V. Miletić, *Prelomna vremena: Milovan Djilas i zapadnoevropska socijalistička i socijaldemokratska levica: 1950-1954* (Beograd: Institut za noviju istoriju Srbije, 2019); Aleksandar V. Miletić, *Titov emisar Milovan Djilas: diplomatsko-pregovaračke i spoljnopolitičke aktivnosti (1943-1953)* (Beograd: Institut za noviju istoriju Srbije, 2021).

34 Vladimir Dedijer, *Jugoslovensko-albanski odnosi: 1939–1948* (Beograd: Borba, 1949).

dhe Marko Peroviq.³⁵ Më pas kemi botime gazetareske të ndërthurura me përshkrime romantike (Pero Zlatar,³⁶ Milenko Babiç³⁷), në të cilat nuk janë shfrytëzuar burimet arkivore dhe literatura profesionale. Duhet veçuar monografia e Milorad Komatinës, që ishte diplomat dhe njohës i Shqipërisë, puna e të cilit bazohej në përvojën e tij dhe kërkimin e burimeve.³⁸ Nikola Gaçesha, Husnija Kamberoviq, Enes Milak, Momçilo Pavloviq dhe Bogumil Hrabak i kanë trajtuar marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare në vitet 1945–1948 nëpër artikujt shkencorë.³⁹

Disa autorë shqiptarë që merren me marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare shpesh nuk konsultohen me historiografinë serbe dhe shkruajnë vetëm në bazë të materialit historik shqiptar, gjë që vë në diskutim objektivitetin e pikëpamjeve historike (Arshi Pipa,⁴⁰ Ramadan Marmullaku,⁴¹ Peter R. Prifti⁴²), por studimet e tyre janë shumë të rëndësishme për kërkime. Shënimet dhe indikacionet e Mile Bjelajac dhe Gordana Krivokapiq Joviç për karakterin e punimeve individuale ishin shumë të vlefshme për shkrimin e monografisë.⁴³

Nuk duhet të mungojnë punimet e përgjithshme që kanë të bëjnë me periudhën e pasluftës, gjegjësisht periudhën e Luftës së Ftohtë, të cilat na ndihmuan të shohim marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare

35 Marko Perović, *Ekonomski odnosi Jugoslavije i Albanije: 1947–1948* (Beograd: Savez novinara Jugoslavije, 1951).

36 Pero Zlatar, *Enver Hodža: politička biografija* (Beograd: Rad, 1986).

37 Milenko Babić, *Enver Hodžina Albanija* (Beograd: Novinska agencija Tanjug, 1981).

38 Milorad Komatina, *Enver Hodža i jugoslovensko-albanski odnosi* (Beograd: Službeni list, 1995).

39 Nikola L. Gaćeša, “Privredni odnosi Jugoslavije i Albanije 1945–1948”, *Zbornik Matice srpske za istoriju* 42 (1990): 87–127; Husnija Kamberović, “Prilog proučavanju odnosa između Jugoslavije i Albanije od 1945 do 1948”, *Glasnik Arhiva i Društva arhivskih radnika Bosne i Hercegovine = Mitteilungen der Archive und des Vereins der Archivare von Bosnien und Herzegovina* 31 (1991): 185–201; Enes Milak, “Spoljnogovinski odnosi Jugoslavije 1945–1948” in *Balkan posle Drugog svetskog rata*, ed. Petar Kačavenda (Beograd: Institut za savremenu istoriju, 1996), 175–181; Momçilo Pavlović, “Albanija između Tita i Staljina” in *Balkan posle Drugog svetskog rata*, 306–315; Bogumil Hrabak, “Međunarodni položaj Albanije 1945–1947. i Jugoslavija”, *Istraživanja* 13 (1990): 249–312.

40 Arshi Pipa, *Albanian Stalinism. Ideo-Political Aspects* (New York: Columbia university press, 1990).

41 Ramadan Marmullaku, *Albania and the Albanians* (London: C. Hurst and Co, 1975).

42 Peter Prifti, *Socialist Albania since 1944. Domestic and Foreign Developments* (Cambridge Mass. [etc.]: MIT Press, cop. 1978).

43 Mile Bjelajac dhe Gordana Krivokapić-Jović, *Prilozi iz naučne kritike – Srpska istoriografija i svet (uticaj jugoslovenske krize na stranu i domaću historiografiju)* (Beograd: Institut za noviju istoriju Srbije, 2011).

në tërësi. Fillimisht duhet parë trekëndëshi i marrëdhënieve Stalin-Tito-Hoxha dhe më pas ndikimi dhe presioni i fuqive perëndimore mbi Shqipërinë. Politika e jashtme e Jugosllavisë dhe marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare janë diskutuar edhe përmes monografive të autorëve të huaj.⁴⁴ Peter Bartl ka dhënë një pasqyrë të marrëdhënieve jugosllavo-shqiptare në librin e tij për shqiptarët nga Mesjeta e deri më sot.⁴⁵ Veçanërisht duhet theksuar se ka autorë vendas që me cilësinë e tyre të kërkimit kanë arritur të botojnë edhe jasht vendit për Luftën e Ftohtë, si Dragan Bogetiqi, që ia kushtoi punën e tij kërkimore kësaj çështjeje. Përfundimet e Aleksandar Zhivotiqit në monografitë dhe diskutimet e tij lidhur me marrëdhëniet midis Jugosllavisë, Shqipërisë, Bashkimit Sovjetik dhe fuqive perëndimore ishin veçanërisht të rëndësishme për kërkimin tonë. Për një kuptim më të gjerë të kontekstit ekonomik dhe marrëdhënieve jugosllavo-shqiptare, ishin të rëndësishme për ne edhe studimet e Ljubodrag Dimiqit⁴⁶ dhe Dragomir Bonxhiqit,⁴⁷ ndërsa në në fushën e kulturës, arsimit sferën ushtarake ishin të rëndësishëm artikujt e Bojan Dimitrijeviqit.⁴⁸

Vendosja e marrëdhënieve të mira mes Jugosllavisë dhe Shqipërisë

Gjatë Luftës së Dytë Botërore u vendosën marrëdhënie midis Partisë Komuniste të Jugosllavisë dhe Partisë Komuniste të Shqipërisë, që morën përmasa të reja pas përfundimit të luftës, sipas modelit të marrëdhënieve jugosllavo-sovjetike. Megjithatë pati raste kur Jugosllavia nuk u konsultua me Moskën për disa çështje, gjë që u

44 Giuseppe Boffa, *Povijest Sovjetskog Saveza*, 2: Od domovinskog rata do položaja druge velesile: Staljin i Hruščov: 1941–1964 (Opatija: “Otokar Keršovani”, 1985); Volter Laker, *Istorija Evrope 1945–1992* (Beograd: Clio, 1999); Mihail Geler and Aleksandr Nekrič, *Utopija na vlasti. Istorija Sovjetskog saveza* (Podgorica: Cid, 2000); John Lewis Gaddis, *Hladni rat. Mi sada znamo* (Beograd: Clio, 2003).

45 Peter Bartl, *Albanci: od srednjeg veka do danas* (Beograd: Clio, 2001).

46 Ljubodrag Dimić, *Agitprop kultura. Agitpropovska faza kulturne politike u Srbiji 1945–1952* (Beograd: Rad, 1988).

47 Dragomir Bondžić, *Beogradski univerzitet 1944–1952* (Beograd: Institut za savremenu istoriju, 2004); Dragomir Bondžić, *Misao bez pasoša: međunarodna saradnja Beogradskog univerziteta 1945–1960* (Beograd: Institut za savremenu istoriju, 2011).

48 Bojan Dimitrijević, “Jugoslovensko-sovjetskivojni odnosi 1945–1948“, *Istorija 20.veka*, nr. 1 (1997): 87–96; Bojan Dimitrijević, “Odnosi jugoslovenske armije i balkanskih armija 1945–1951“ në *Balkan posle Drugog svetskog rata*, red. Petar Kačavenda (Beograd: Institut za savremenu istoriju, 1996), 374–388.

shpjegua me “revolucionin autentik jugosllav”.⁴⁹ Jugosllavia përdori të njëjtat forma bashkëpunimi që kishte me Bashkimin Sovjetik në marrëdhëniet e saj me Shqipërinë. Komunistët jugosllavë u mbështetën në Moskë dhe shqiptarët në Beograd; komunistët jugosllavë kishin si prijës Titon, por edhe Stalinin, ndërsa ata shqiptarë Enver Hoxhën dhe Titon. “Tito ishte Stalin për ne edhe falë Stalinit”, shkruante Hoxha. Të njëjtën mënyrë me anë të së cilës BRSS ndihmoi Jugosllavinë ideologjikisht, politikisht, ekonomikisht, ushtarakisht dhe kulturalisht, përdori edhe Jugosllavia për Shqipërinë.⁵⁰

Mes këtyre dy vendeve u krijua një atmosferë vëllazërimi, miqësie dhe bashkëpunimi. Ato i lidhte fakti se në vitin 1945, si Shqipërisë ashtu edhe Jugosllavisë iu desh të kalonin një proces të vështirë rindërtimi të vendit. Megjithëse nuk u rikuperua shpejt, shteti jugosllav filloi t’i jepte ndihmë Shqipërisë. Ndihma nënkuptonte ndihmën ideologjike, politike, ekonomike, shëndetësore, ushtarake dhe kulturore. Shqipëria kishte një pozitë të konsiderueshme gjeostrategjike, ndaj kishte shpesh vëmendjen e fuqive botërore dhe të fqinjëve. Jugosllavia ishte shumë e pranishme në Shqipëri, prandaj nga analistët perëndimorë ajo nisi të konsiderohej si krahinë jugosllave, politika e së cilës udhëhiqej nga ndërhyrjet jugosllave në punët shtetërore, partiake dhe të jashtme.⁵¹ Jugosllavia kishte interesat e saj në një vend të vogël si Shqipëria, ndërsa Shqipëria kishte nevojë për një fqinj dhe mbrojtës të fortë dhe të fuqishëm. Për këtë arsye nisën të zhvillohen marrëdhëniet e bashkëpunimit, që do të zgjasnin, pak a shumë e me keqkuptime deri

49 Leo Mates, *Međunarodni odnosi socijalističke Jugoslavije* (Beograd: Nolit, 1976), 93–100; Ljubodrag Dimić, *Josip Tito – Josif Staljin* (Beograd: Arhiv Srbije i Crne Gore, 2006), 5–11; Nekrić, *Utopija na vlasti*, 424–425; Dragan Bogetić, „Jugoslavija između Istoka i Zapada“ in- *Jugoslavija u Hladnom ratu*, ed. Aleksandar Životić (Beograd: Institut za noviju istoriju Srbije, 2010), 14; Harold Lydall, *Yugoslav Socialism: Theory and Practice*, (Oxford: Clarendon Press, 1984), 59–60; Branko Petranović, *Istorija Jugoslavije 1918–1988*, III (Beograd: Nolit, 1988), 201; Ljubodrag Dimić, *Istorija srpske državnosti. Srbija u Jugoslaviji*, III (Novi Sad: Srpska akademija nauka i umetnosti, 2001), 339; Bilandžić, *Društveni razvoj socijalističke Jugoslavije*, 51–53; Đoko Tripković, “Spoljni faktori i politička kretanja u Jugoslaviji 1945–1955“, *Istorija 20. veka*, nr. 2 (1995): 80; *Pregled istorije Saveza komunista Jugoslavije*, (Beograd: Institut za izučavanje radničkog pokreta, 1963), 475; Marko Pejović, “Sovjetski filmovi prikazani u Jugoslaviji 1945–1948. u organizaciji Društva za kulturnu saradnju Jugoslavije sa SSSR-om”, *Godišnjak za društvenu istoriju*, nr. 1(2010): 89–103.

50 Pavlović, “Albanija između Tita i Staljina”, 307.

51 Ornela Shameti, “Albanian-Yugoslav Relations in the International Optics”, *Academic Journal of Business, Administration, Law and Social Sciences*, no 1, vol 6 (2020), 119-124.

në prishjen përfundimtare në 1948. Jugosllavia ishte fqinje e Shqipërisë me një linjë të gjatë kufitare nga Buna në Ohër dhe Strugë. Ishte gjithashtu një vend që mund të jepte ndihmë ekonomike. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, Jugosllavia mbajti peshën kryesore të luftës dhe pas saj e mbrojti Shqipërinë nga ndërhyrja e aleatëve perëndimorë. Për të arritur ekuilibrin në Ballkan dhe për të mbrojtur në mënyrë strategjike kufijtë e saj, Jugosllavia ishte aleate e natyrshme kundër depërtimit të Italisë në Ballkan dhe më pas kundër Greqisë, që kërkonte rishikim të kufirit të saj verior. Kështu, Jugosllavia ndihmoi komunistëtshqiptarë në Luftën e Dytë Botërore,⁵² i dha mbështetje ndërkombëtare në fund dhe pas luftës, si dhe ndihmë të konsiderueshme ekonomike.⁵³ Këshilltarët jugosllavë u përfshinë pothuajse në të gjitha çështjet shtetërore. Në të vërtetë, për shumë vëzhgues të jashtëm në periudhën e menjëhershme të pasluftës, dukej se Shqipëria do të bëhej përfundimisht një republikë jugosllave.⁵⁴

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, Jugosllavia dhe Shqipëria vazhduan bashkëpunimin e krijuar gjatë luftës, kur thelbi i politikës ishte lufta kundër armikut të përbashkët. Të dy vendet kishin interesa të ngjashme - pavarësinë dhe ndërtimin e një rendi të ri shoqëror. Çështja themelore strategjike ishte nëse Shqipëria duhej të zhvillonte në mënyrë të pavarur marrëdhëniet e drejtpërdrejta me vendet e tjera, apo nëpërmjet Jugosllavisë në drejtim të rritjes së afrimit të ndërsjellë, me parakushtet për bashkim. U llogarit se Shqipëria do të ishte një anëtare e besueshme e federatës ballkanike.⁵⁵

Për të krijuar marrëdhënie miqësore, në mesin e vitit 1944, në Shqipëri u dërgua si instruktor kolonel Velimir Stojnić, i cili duhej t'i jepte ndihmë Partisë Komuniste të Shqipërisë (PKSH). Ai mori pjesë

52 Një përshkrim të unitetit gjatë luftës mund ta gjejmë edhe në ditarin e Dushan Mughoshës, i cili në maj 1944 nën direktivat e Komitetit Qendror të PKJ u zhvendos pranë stafit të përgjithshëm në Kosovë e Metohi, ku qëndroi për një kohë edhe pas mbarimit të luftës.

53 Branko Petranović, *Jugosllavija, velike sile i balkanske zemlje 1945–1948: Iskustvo "narodne demokratije" kao partijske države* (Beograd, Podgorica: Istorijski institut Crne Gore, 1994), 113.

54 Elidor Mëhilli, *From Stalin to Mao: Albania and the Socialist World* (Cornell University Press, 2017), 168.

55 Đorđe Borozan, "Jugosllavija i Albanija. Prva poratna iskustva" në *Balkan posle Drugog svetskog rata*, 287. Për më shumë informacion mbi Federatën Ballkanike shih: Slavoljub Cvetković, "Pokušaji stvaranja balkanske federacije 1944–1948" në *Balkan posle Drugog svetskog rata*, 46–51; Серж Мете, *История на Албанците: от илирите до независимостта на Косово* (Софија: Рива, 2007) (Serzh Mete, *Istorija na Albancite: ot ilirite do nezavisimostta na Kosovo* (Sofija: Riva, 2007)), 299–300; Branko Petranović, *Balkanska federacija 1943–1948*, (Šabac: Zaslón, 1991), 155.

edhe në kongresin e Beratit, si i dërguari i parë i qeverisë së përkohshme të Jugosllavisë Federale Demokratike (JFD) në Tiranë. Kur u vendosën marrëdhëniet e drejtpërdrejta ndërmjet KQ të PKJ-së dhe Komitetit Qendror të PKS-së, Velimir Stojniçeshti së kryeri detyrat e tij (11 tetor 1945). Bashkë me të, në pozitën e sekretarit të misionit ushtarak të Ushtrisë Popullore Çlirimtare të Jugosllavisë në Shtabin Suprem të Ushtrisë Popullore Çlirimtare të Shqipërisë, u dërgua edhe Nijaz Dizdareviq, instruktor i organizatës së rinisë së luftës.⁵⁶ Jugosllavia ishte vendi i parë që njohu shtetin e Shqipërisë më 28 prill 1945⁵⁷ dhe më 10 nëntor të po këtij viti, Bashkimi Sovjetik bëri të njëjtën gjë.⁵⁸ Velimir Stojniqi u emërua ambasadori i parë jugosllav,⁵⁹ dhe misioni ushtarak jugosllav u riemërua si Ambasada e JFD-s.⁶⁰

Me synimin për të krijuar një bashkëpunim më të ngushtë, Jugosllavia dhe Shqipëria nënshkruan dy traktate të vitit 1945, një në formën e një aleance ushtarake për luftën e përbashkët kundër forcave pushtuese gjermane, e cila do të shtrihej në vitet e pasluftës, dhe tjetra që ishte traktat për bashkëpunimin ekonomik midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë.⁶¹ Me Marrëveshjen Tregtare, vlera e përgjithshme e dërgesave reciproke arriti në rreth 40 milionë dinarë. Sipas asaj marrëveshjeje, Jugosllavia dërgoi në Shqipëri 2991 ton grurë, 5717 ton misër, 106 ton fasule, 2000 ton çimento dhe materiale të tjera. Këtë mund ta shohim nga Protokollin e nënshkruar nga të dyja palët gjatë krijimit të Marrëveshjes Tregtare.⁶² Krahas pretendimeve kontraktuale, Shqipëria mori edhe ndihmë jashtë marrëveshjes nga Jugosllavia.⁶³ Marrëdhëniet me Shqipërinë po zhvilloheshin edhe në nivele të tjera. Shteti jugosllav e përhapte propagandën në Shqipëri përmes shtypit, botimeve dhe të

56 Nijaz Dizdareviqi qëndroi në këtë pozitë deri në maj të vitit 1945, kur u caktua Sekretar i Parë i Ambasadës Jugosllave në Ankara, ku qëndroi deri në fillim të vitit 1947.

57 *Jugosllavija 1918–1988. Tematska zbirka dokumenata*, 791.

58 Bartl, *Albanci: od srednjeg veka do danas*, 233.

59 Në fazën e parë të vendosjes së marrëdhënieve ekonomike mes Jugosllavisë dhe Shqipërisë, u mendua se duheshin hapur konsullata jugosllave në Shkodër, Vlorë dhe Gjirokastrë, por më pas kjo ide u braktis. (Bogumil Hrabak, “Međunarodni položaj Albanije 1945–1947. i Jugosllavija”, *Istraživanja*, no.13 (1990): 260).

60 Komatina, *Enver Hodža i jugoslovensko-albanski odnosi*, 42; *Zapisnici sa sednica Politbiroa CK KPJ (11. jun 1945 – 7. jul 1948)*, 469–470.

61 Slobodan Selinić dhe Dušan Bajagić, *Jugosllavija i svet 1945–1950. Hronologija* (Beograd: Institut za noviju istoriju Srbije, 2010), 46.

62 AJ, 50-48-105, Protocol on the conclusion of the Trade Agreement, July 1, 1946.

63 AJ, 507/9,1/1-37, *Borba*, November 20, 1945.

një librarië jugosllave në Tiranë. Gjithashtu, në Shqipëri u organizuan kurse të gjuhës serbe dhe u dërguan mësues jugosllavë. U sugjerua që studentët shqiptarë të pranoheshin në universitetet dhe shkollat jugosllave me bursë jugosllave. Të rinjtë shqiptarë kalonin kohë edhe në Jugosllavi, përshembull si pjesëmarrës në Kongresin Rinor Antifashist të Vendeve Ballkanike. Nisi të krijohej edhe bashkëpunimi mjekësor e shëndetësor; nga Jugosllavia dërgoheshin në Shqipëri barna, ndërsa një ekip mjekësor qëndroi një muaj në Shqipëri.⁶⁴ Çështja që ishte shumë e rëndësishme për t'u rregulluar ishte ajo e marrëdhënieve kufitare, ndaj u aranzhua një marrëveshje për menaxhimin e trafikut kufitar.⁶⁵

Një bashkëpunim më i mirë dhe më i ngushtë midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë u pengua nga rezervat dhe mosbesimi i Enver Hoxhës, kryesisht për shkak se marrëdhëniet Jugosllavi-Shqipëri ishin shenjuar nga konflikte në dekadat e fundit. Megjithatë, bashkëpunimi i krijuar jugosllavo-shqiptar kontribuoi në rimëkëmbjen ekonomike dhe politike të Shqipërisë. Kështu nisi dalja nga kriza dhe u bënë plane për zhvillime të mëtejshme.⁶⁶ Nisi zbatimi i një reforme shumë të gjerë agrare.⁶⁷ Viti 1945 përfundoi me zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese në Shqipëri, të cilat u fituan nga Fronti Demokratik i drejtuar nga Enver Hoxha.⁶⁸ Kushti për njohjen e Shqipërisë nga fuqitë perëndimore ishte që zgjedhjet të ishin të lira me pjesëmarrjen e të gjitha forcave antifashiste.⁶⁹ Pas përfundimit të zgjedhjeve, Perëndimi arriti në përfundimin se ato nuk ishin ashtu siç kërkoheshin, ndaj Shqipëria u detyrua të lidhte aspiratat e saj me Jugosllavinë dhe Bashkimin Sovjetik në vitet e ardhshme.⁷⁰

64 Slavković Mirić, *Jugoslavija i Albanija 1945-1948: ekonomski odnosi*, 102-105

65 Slavković Mirić, "Pogranični promet Jugoslavije i Albanije i dvovlasnička imanja 1945-1948", *Istorija 20. veka*, nr.1(2020): 107-128.

66 Slavković Mirić, *Jugoslavija i Albanija 1945-1948: ekonomski odnosi*, 105-116.

67 ADMPJRS, AP, 1945, d.nr. 7, sign. 2453, Një përmbledhje e shkurtër e situates politike në Shqipëri, 1945; ADMPJRS, AP, 1945, d. nr. 9, sign. 1/158, Ministria e Bujqësisë dhe Pyjeve, 1945; ADMPJRS, AP, 1948, dos. 1, d. nr. 8, sign. 43663, „Službeni list – Lista shërbyese” nr. 20, 11 korrik 1945; AJ, 112-800-801, 17 nëntor 1946; Marija Obradović, "Narodna demokratija" u Jugoslaviji 1945–1952(Beograd: INIS, 1995), 52.

68 Geoffrey Swain and Nigel Swain, *Eastern Europe since 1945*(Houndmills [etc.]: Macmillan, 1993), 28.

69 Geoffrey Swain and Nigel Swain, *Eastern Europe since 1945*(Houndmills [etc.]: Macmillan, 1993), 28.

70 AJ, 112-788-789, 27 tetor 1945; AJ, 507/9, kutia 1, 1/1-37, *Borba*, 1 tetor 1945.

Kulmi i bashkëpunimit mes Jugosllavisë dhe Shqipërisë

Në janar 1946 u shpall Republika Popullore e Shqipërisë. U miratua kushtetuta, që ishte e ngjashme me atë jugosllave.⁷¹ Shqipëria u përpoq gjithashtu të siguronte pozicionin e saj në politikën e jashtme. Shteti shqiptar mori mbështetjen jugosllave për të marrë pjesë në Konferencën e Parisit.⁷² Edhe Jugosllavia e mbështeti Shqipërinë në aplikimin e saj për anëtarësim në Kombet e Bashkuara.⁷³

Krahas rregullimit të situatës politike, një nga detyrat kryesore të udhëheqjes shqiptare ishte përmirësimi i gjendjes ekonomike të popullsisë.⁷⁴ Në shkurt 1946, në Plenumin e Pestë të KQ të Partisë Komuniste të Shqipërisë, u vendos që Shqipëria t'i kthehej patjetër Jugosllavisë. Me përfundimin e periudhës së rindërtimit atje, rritjen e prodhimit dhe fillimin e realizimit të Planit të parë Pesëvjeçar, u krijuan mundësitë për ta bërë bashkëpunimin me Shqipërinë më të bollshëm dhe të gjithanshëm. Objektivi kryesor i këtij bashkëpunimi ishte lehtësimi i zhvillimit të ekonomisë shqiptare, me qëllim përmirësimin e pozitës ekonomike dhe kulturore të Shqipërisë dhe forcimin e fuqisë mbrojtëse të vendit.⁷⁵ Për këtë arsye, Ministria e Tregtisë së Jashtme të Jugosllavisë emëroi Hugo Havličekun, nga Ministria e Tregtisë dhe Furnizimit, si të dërguar tregtar në Tiranë.⁷⁶

Duke qenë se, Shqipëria ishte një vend bujqësor, veçanërisht kjo degë e ekonomisë duhej të përmirësohej. U zbatua reforma në industrinë blegtorale;⁷⁷ Shteti shqiptar punoi për avancimin e industrisë, elektrifikimin dhe rregullimin e pozitës së punëtorëve dhe

71 AJ, 112-791-792, 13 janar, 1946.

72 Aleksandar Životić, “Pitanje Albanije u odnosima Jugoslavije i Zapada 1945–1947”, *Istorija 20. veka*, nr.3 (2010):90; Petranović, *Istorija Jugoslavije*, III, 178; Marmullaku, *Albania and the Albanians*, 115; Gavro Perazić, “Jugoslovensko-albanski odnosi u odnosu na teritorijalni integritet”, *Ideje*, nr. 5–6 (1987): 96.

73 *Bela knjiga o neprijateljskoj politici Vlade Narodne Republike Albanije prema Federativnoj Narodnoj Republici Jugoslaviji*, 118; *Ekspoze Maršala Tita o spoljnoj politici Jugoslavije: održan na zajedničkoj sednici Savezne skupštine i Skupštine naroda 1 aprila 1946*, 8.

74 AJ, 507/9, kutia 1, 1/1-45, *Luftetari*, 23 shkurt 1946; AJ, 507/9, box 1, 1/1-46, 26 shkurt 1946; AJ, 507/9, kutia 1, 1/1-37, *Bashkimi*, 21 Janar 1946; Zlatar, *Enver Hodža: politička biografija*, 109–110; Prifti, *Socialist Albania since 1944. Domestic and Foreign Developments*, 54; Krempton, *Balkan posle Drugog svetskog rata*, 69.

75 Dedijer, *Jugoslovensko-albanski odnosi: 1939–1948*, 142.

76 *Ibid*, 173.

77 Krempton, *Balkan posle Drugog svetskog rata*, 70.

sindikatave.⁷⁸ E gjithë kjo kërkonte ndihmë materiale, si dhe ndihmë në kuadro profesionale, që ishte arsyeja që bashkëpunimi ekonomik me Jugosllavinë po zhvillohej gjithnjë e më shumë. U nënshkrua marrëveshja për krijimin e trafikut kufitar Jugosllavi-Shqipëri,⁷⁹ përfaqësuesi jugosllav në Shqipëri vizitoi qendrën industriale në Kuçovë⁸⁰ dhe u nënshkrua një marrëveshje për tregtinë dhe pagesat.⁸¹ Gjuha jugosllave po përmirësonte komunikimin. Ekspertët jugosllavë u dërguan në Shqipëri dhe statusi i tyre rregullohej me protokoll.⁸² Kështu, 41 topografë u dërguan për të ndihmuar në zbatimin e reformës agrare, ekspertë të kulturës për të ndihmuar në ngritjen e teatrove, si dhe ekspertë mjekësorë në fushën e shëndetësisë etj. Punëtorët shqiptarë u punësuan në kompanitë jugosllave, dhe 96 studentë nga Shqipëria studionin në universitetet jugosllave (sipas një raporti jugosllav të dhjetorit 1946).⁸³

Pika kryesore e bashkëpunimit mes Jugosllavisë dhe Shqipërisë ishte vizita e Enver Hoxhës në Jugosllavi në mesin e vitit 1946.⁸⁴ U nënshkrua një traktat mbi bashkëpunimin ekonomik, pagesat dhe huatë, i ndjekur nga Traktati i Miqësisë dhe Ndihmës në Tiranë.⁸⁵ Ky traktat parashikonte që Jugosllavia t'i jepte hua Shqipërisë për blerjen e materialeve dhe mjeteve për ndërtimin e industrisë, si dhe ndihmë në të gjitha degët e ekonomisë duke dërguar ekspertë jugosllavë dhe duke

78 AJ, 50-48-105, Raporti i elektrifikimit, 15 gusht 1946; AJ, 836, 1-3-v/23, Raport mbi gjendjen e industrisë shqiptare dhe nevojat e saj, 4.

79 AJ, 112-792-793, 17 prill 1946; DAMFARS, PA, 1946, doc.no. 4, sign. 4307, Dërda to the Ministry of Foreign Affairs, April 15, 1946.

80 ADMPJRS, AP, dosja 1, 1946, dok. 5, sign.6777, Gjergja për MPJ, 10 qershor 1946.

81 AJ, 50-48-105, Marrëveshja mbi tregtinë dhe pagesat, maj 1946.

82 ADMPJRS, AP, dosja 2, 1946, dok. 1, sign.6897, Protocol, July 6, 1946.

83 ADMPJRS, AP, dosja 2, 1946, dok. 1, sign. 7238, Gjergja për MPJ, 19 maj 1946; ADMPJRS, AP, dosja 2, 1946, dok. 1, sign. 10639, Ministria e Punës për të MPI, 12, qershor 1946; ADMPJRS, AP, dosja 2, 1946, dok. 2, sign. 6206, Gjergja për MPJ, 25 maj 1946; ADMPJRS, AP, dosja 2, 1946, dok. 2, sign. 2/69, Ambasada e Shqipërisë në Beograd, 16 Shkurt 1946; ADMPJRS, AP, dosja 2, 1946, dok. 6, sign. 867, Ministria e Minierave të RFPJ për MPJ, 24 janar 1946; ADMPJRS, AP, dosja 2, 1946, dok. 10, sign. 14512, Komiteti i shkollave dhe shkencës së qeverisë së RFPJ, MPJ, 7 dhjetor 1946.

84 *Hronologija revolucionarne delatnosti Josipa Broza Tita*, red. Branislav Ilić dhe Vojislav Ćirković (Beograd: Export-press, 1978), 107. Tito vizitoi vendet me të cilat Jugosllavia nënshkroi marrëveshje më 1946 dhe 1947, por, jo Shqipërinë. (Slobodan Selinić, „Jugosllavia, SSSR i istočnoevropske zemlje 1944–1948”, në *Oslobodenje Beograda 1944*, red. Aleksandar Životić (Beograd: Institut za noviju istoriju Srbije, 2014), 400).

85 Komatina, *Enver Hodža i jugoslovensko-albanski odnosi*, 48; Dedijer, *Jugoslovensko-albanski odnosi: 1939–1948*, 152–154.

hartuar projekte. Marrëveshja parashikonte gjithashtu themelimin e shoqërive të përziera shqiptaro-jugosllave, të cilat supozohej të ishin shoqëri aksionere me pjesëtë barabarta kapitali. Kompanitë e përziera ishin të nevojshme sepse kishte një moszhvillim të trashëguar nga pala shqiptare, mungesë kuadri profesional dhe përvoja. Qeveria jugosllave propozoi hua për këto kompani që do të lejonin që Shqipëria të bëhej pronare e plotë e investimeve.⁸⁶ U vendos kurs i ri mes dinarit dhe frangut të ri shqiptar.⁸⁷ Gjithashtu, qeveria shqiptare miratoi për vitin 1946/47 buxhetin e parë të planifikuar.⁸⁸ Në nëntor 1946 u nënshkrua Marrëveshja për harmonizimin e planeve ekonomike, për bashkimin doganor dhe për barazimin e valutave ndërmjet dy vendeve, që ishte një shembull unik i rregullimit të ekonomisë midis dy vendeve socialiste.⁸⁹ Përveç ndihmës që i vinte Shqipërisë sipas marrëveshjes së nënshkruar, Jugosllavia e shtriu ndihmën e saj edhe në fusha të tjera. Në tetor të vitit 1946, pas përmbytjeve në Shqipëri, në Jugosllavi u mblodhën ndihma prej 52 milionë dinarë.⁹⁰

Marrëdhëniet me Jugosllavinë u thelluan në Plenumin e Zgjeruar të KQ PKSH në dhjetor 1946. Një bashkëpunim i tillë çoi në krijimin e parakushteve për bashkimin e të dyja ekonomive. “Rruga e përbashkët drejt socializmit”, “vëllazëria e gjakut në luftë” dhe fraza të tjera, të dëguara shpesh në fjalimet e shtetarëve më të lartë të të dy vendeve, jepnin përshtypjen se bashkëpunimi ishte i ndërsjellë dhe i dëshirueshëm.⁹¹

Kriza në marrëdhëniet mes dy vendeve dhe ndërprerja e bashkëpunimit

Viti i ri 1947 filloi me shpalljen e rezultateve të rinovimit dhe rindërtimit të Shqipërisë gjatë vitit pararendës.⁹² U krijuan linja të rregullta transporti, u rindërtuan rrugët dhe urat, gjë që ishte e

86 *Balkanski ugovorni odnosi, II* (1919–1945), 4–6.

87 AJ, 50-49-108, *Bashkimi*, 11 korrik 1946.

88 AJ, 112-797-799, 4 gusht 1946.

89 AJ, 50-48-105, Marrëveshje mes qeverive të Jugosllavisë dhe Shqipërisë për harmonizimin e planeve ekonomike, bashkimit doganor dhe barazimin e monedhave, 27 nëntor 1946.

90 AJ, 50-48, 28 tetor 1946; AJ, 112-801-802, 15 nëntor 1946; AJ, 112-800-801, 25 nëntor 1946; AJ, 507/9, 1/1-37, *Borba*, 6 nëntor 1946.

91 AJ, 507, 1/1-1-126, Rezoluta e KQPKSH.

92 AJ, 112-803-804, *Bashkimi*, 10 janar 1947.

rëndësishme për bashkëpunimin tregtar me Jugosllavinë. U asfaltua rruga Tiranë-Durrës, u ndërtua rruga Berat-Çorovodë, u vu në punë një termocentral në Kukës, po zhvillohej prodhimi i naftës në Kuçovë, u planifikua ndërtimi i një spitali në Gjirokastër dhe një gjimnazi në Peshkopi.⁹³ U hartua plani ekonomik kombëtar, i cili parashikonte investime në bujqësi dhe industri.⁹⁴ U vendosën çmime uniforme.⁹⁵ Në përcaktimin e çmimeve të mallrave të importuara nga Jugosllavia, çmimet jugosllave u morën si bazë plus 3% për koston e transportit në Shqipëri dhe marzhet tregtare për Shoqërinë Jugosllavo-Shqiptare për Import dhe Eksport.⁹⁶ U miratua buxheti për periudhën prill-dhjetor 1947, i cili u balancua me shumën në shpenzime dhe të ardhura prej 3 627 394 900 lekë.⁹⁷ Jugosllavia i mundësoi Shqipërisë hapjen e një fabrike sheqeri, sardelesh dhe fabrikë marmelate. Më pas, për të ndihmuar në zhvillimin e industrisë së tekstilit, shteti jugosllav bleu një makineri tjerrese pambuku me kapacitet të madh në Shtetet e Bashkuara për Shqipërinë. Gjithashtu, për në Shqipëri u transportua makineria e përpunimit të kërpit, me të cilën u ndërtua fabrika në Rogozhinë, ndërsa në Tiranë po ndërtohej një fabrikë tekstili. Përveç kësaj, sipas këshillave jugosllave, furnizimet e dëmshpërblimit që Shqipëria merrte nga Gjermania u përdorën për ndërtimin e një fabrike metali për prodhimin e pjesëve të këmbimit dhe pajisjeve bujqësore, e cila u kompletua me makineri nga Jugosllavia. Shqipëria mori edhe dy sharra me staf ekspert për instalim dhe funksionim. U instalua një shtypshkronjë moderne me makineri të dërguara nga Jugosllavia, si dhe një central telefonik automatik.⁹⁸ Rëndësi të madhe për komunikimin kishte hekurudha Durrës-Peqin, e cila u hap më 7 nëntor 1947.⁹⁹ Përveç fabrikave dhe hekurudhës, Jugosllavia ndihmoi

93 AJ, 112-805-806, 10 shkurt 1947; AJ, 112-810-811, 28 prill 1947; AJ, 112-812-813, 19 maj 1947; AJ, 112-813-814 qershor 1947; AJ, 112-813-814, 8 qershor 1947; AJ, 112-816-817, 7 gusht 1947.

94 AJ, 112-811-812, 5 maj 1947.

95 AJ, 112-815-816, 9 korrik 1947. Lista e çmimeve me shpjegimet mund të gjendet në dokumentin: AJ, 50-52-111, 16 maj 1947.

96 ADMPJRS, AP, dosja 1, 1947, dok.23, sign.414585, Raport i Sekretarit të Ambasadës Osman Gjikiq mbi çmimet e disa prodhimeve industrial, bujqësore e të tjera në Shqipëri. 2 gusht 1947.

97 AJ, 50-56-118, Qarkullimi i parasë dhe sistemit financiar e bankar pas çlirimit të Republikës Popullore të Shqipërisë, 8 nëntor 1948.

98 AJ, 112-824-825, 2 nëntor 1947; Perović, *Ekonomski odnosi Jugoslavije i Albanije: 1947-1948*, 102-103.

99 AJ, 112-824-825, 8 nëntor 1947.

edhe në ndërtimin e hidrocentralit të Selitës së Madhe pranë Tiranës, si dhe në furnizimin me ujë.¹⁰⁰

Nga fundi i vitit 1947, kredia ishte shfrytëzuar me 1,356,811,698,49 (83%), ndërsa mallrat e prodhimit jugosllav, me vlerë 912,637,758 (80%) ishin dërguar ose ishin rrugës për në Shqipëri. Gjithashtu, mallrat e importuara nga Jugosllavia për Shqipërinë, me vlerë 111,683,436 (22%), ishin dorëzuar ose ishin rrugës për në Shqipëri. Duke analizuar burimet e të ardhurave buxhetore, vetëm 21.1% e të gjitha të ardhurave vinin nga burime shqiptare, ndërsa 78.8% ishin me origjinë të huaj dhe kjo ishte rreth 20% nga asistenca e UNNRA-s dhe 56.75% nga kredia jugosllave e mallrave që Shqipëria përdorte për blerjen e mallrave.¹⁰¹

Me gjithë përmirësimin e ekonomisë së shtetit shqiptar, të mundësuar nga ndihma jugosllave, në udhëheqjen shqiptare ishin evidente rezervat dhemosbesimi.¹⁰² Edhe pse bashkëpunimi mes Jugosllavisë dhe Shqipërisë përfaqësohej nga nivelet më të larta zyrtare, në praktikë nuk ishte kështu. Delegati jugosllav i dërguar në Shqipëri, në gusht 1946, Savo Zlatiq, shkruante në një raport drejtuar Komitetit Qendror të PKJ-së në fillim të shkurtit 1947 se udhëheqja shqiptare kishte bërë lëvizje logjike duke zgjedhur bashkimin me Jugosllavinë,¹⁰³ por në fund të shkurtit do të shkruante se, “disa shokë udhëheqës kanë rezerva për Jugosllavinë”.¹⁰⁴ Kjo gjë e vështirësonte bashkëpunimin. Do të theksohej veçanërisht dështimi i Jugosllavisë për të zbatuar plotësisht planin, duke injoruar parregullsitë dhe mangësitë që çuan në moszbatimin e marrëveshjes tregtare.¹⁰⁵ Udhëheqësit shqiptarë kishin frikë nga aspiratat e Jugosllavisë për të aneksuar Shqipërinë në federatën e saj.¹⁰⁶ Enver Hoxha i shihte ndihmën jugosllave dhe anëtarët pro-jugosllavë të partisë (Koçi Xoxe, Pandi Kristo) si presion.¹⁰⁷

100 Dedijer, *Jugoslovensko-albanski odnosi: 1939–1948*, 187.

101 AJ, 50-49-490, Huatë 2 miliardë dinarë për vitin 1947; AJ, 50-48-690, *Disa probleme mes RFPJ-s dhe Shqipërisë rreth bashkëpunimit ekonomik*.

102 Životić, *Jugoslavija, Albanija i velikesile 1945–1961* (Beograd: Arhipelag, Institut zanovijuis-toriju Srbije, 2011), 203.

103 BorisSuljagić, “Odnos jugoslovenskoga i albanskog komunističkog vrha od kraja Drugog sv-jetskog rata do prekida odnosa (1945-1948)”, *Časopis za suvremenu povjest* 1/2019, 221.

104 AJ, 507/9, 1/1-127/242, 20 shkurt 1947.

105 Slavković Mirić, *Jugoslavija i Albanija 1945-1948: ekonomski odnosi*, 274-290.

106 Đorđe Borozan, “Jugoslavija i Albanija. Prva poratna iskustva” në *Balkan posle Drugog svetskog rata*, 287.

107 Enver Hoxha, *Rapport d'activité du Comité central du Parti du travail d'Albanie: présenté au*

Ai nuk ishte i gatshëm të ndante pushtetin me udhëheqjen jugosllave apo përfaqësuesit e tyre në Shqipëri.¹⁰⁸ Kjo ishte arsyeja që udhëheqësi shqiptar shprehu dëshirën e tij për bashkëpunim të drejtpërdrejtë me BRSS-në, megjithëse Stalini e referoi atë për bashkëpunim me Jugosllavinë. Në të njëjtën kohë, udhëheqja sovjetike, nëpërmjet përfaqësuesit të saj në Tiranë, monitoronte situatën dhe zhvillimin e marrëdhënieve të Shqipërisë me Jugosllavinë.¹⁰⁹ Në një atmosferë kaq të tensionuar vazhdonin vlerësimet zyrtare të investimeve jugosllave në Shqipëri në shtypin dhe udhëheqjen shqiptare.¹¹⁰ Të dy vendet nënshkruan Marrëveshjen Tregtare më 22 qershor 1947.¹¹¹

Kriza në marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare u ndje veçanërisht pas vizitës së Enver Hoxhës në Moskë në mesin e vitit 1947, pa u konsultuar më parë me autoritetet jugosllave.¹¹² Më pas, Shqipërisë iu dha ndihma për ngritjen e një fabrike për prodhimin e makinerive bujqësore dhe u dhanë traktorë, pra atë që shteti shqiptar nuk mund ta merrte nga Jugosllavia.¹¹³ Me gjithë këtë atmosferë mosbesuese, marrëdhëniet e ndërsjella ekonomike dhe të tjera të Jugosllavisë dhe Shqipërisë vazhduan.¹¹⁴ Por, rënia do të ndjehej në të gjitha fushat. Incidentet kundër ekspertëve dhe qytetarëve jugosllavë po bëheshin shumë të zakonshme.

Mosmarrëveshjet me Jugosllavinë ishin mjaft të dukshme në kohën e barazimit të lekut shqiptar me dinarin jugosllav, kur pala shqiptare punoi pa pëlqimin e Komisionit të Përzier Koordinues, si dhe

VIIIe Congrès du PTA le 1er novembre 1981, (Tirana: Editions „8 Nëntori“, 1981); Hodža, *Titoisti*, 403–406.

108 Pranvera Dibra, “Economic Agreements in the Yugoslav-Albanian Relations”, *Mediterranean Journal of Social Sciences* nr. 13, vol 5 (2014), 292.

109 Komatina, *Enver Hodža i jugoslovensko-albanski odnosi*, 58.

110 AJ, 507/9, 1/1-128, *Bashkimi*, 1 maj, 1947; AY, 507/9, 1/1-138, maj 1947.

111 AJ, 50-259, Marrëveshja mbi shkëmbimin tregtar mes Jugosllavisë dhe Shqipërisë, 22 qershor 1947.

112 Životić, „Jugosllavija i jačanje sovjetskog uticaja u Albaniji 1947–1948“, *Tokovi istorije*, nr. 3 (2009):97; Blendi Fevziu, *Enver Hodža: prva biografija zasnovana na dokumenti od ličnata arhiva i na ispovedite na onie što go poznavaa* (Skopje: Fondacija Otvoreno opštество - Makedonija, 2014),318.

113 Zlatar, *Enver Hodža: politička biografija*, 123; Hoxha, *Avec Staline: souvenirs*, 55–90; *Histoire de l'Albanie: des origines à nos jours*, red. Stefanaq Pollo dhe Arben Puto (Roanne: Editions Horvath, 1974), 308.

114 ADMPJRS, AP, dosja1, 1947, dok.1, sign9141, Ambasada e RPFJ MPJ-s së RPFJ-s, Raport mbi udhëtimin e Kryeministrit të Shqipërisë, 1 tetor 1947; AJ, 112-825-826, 21 nëntor 1947; *Ibid*, 8 dhjetor 1947; *Ibid*, 10 dhjetor 1947.

në kohën e hartimit të Planit Pesëvjeçar Shqiptar, të cilin jugosllavët e patën konsideruar “joreal dhe autarkik”.¹¹⁵ Ndërhyrja sovjetike në marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare u bë më intensive, duke çuar në mosmarrëveshje dhe konflikte të hapura vitin e ardhshëm.

Kriza në marrëdhëniet jugosllave me Bashkimin Sovjetik për Shqipërinë erdhi në fillim të vitit 1948, kur sovjetikët protestuan sepse nuk ishin të informuar për vendosjen e mundshme të trupave jugosllave në Shqipëri, që u braktis pas ndërhyrjes sovjetike.¹¹⁶ Bashkëpunimi midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë, megjithëse u theksua dhe u rikonfirmua në Pleniumin VIII në shkurt 1948, ishte në rënie.¹¹⁷ Ndarja zyrtare erdhi pas publikimit të Rezolutës së Informbyrosë në qershor 1948. Shqipëria ra dakord me këtë rezolutë dhe ndërpreu të gjitha traktatet me Jugosllavinë, përveç Traktatit të Miqësisë, të cilin Jugosllavia e ndërpreu më 12 nëntor 1949.¹¹⁸ Të gjitha projektet në vazhdim u ndërpreu dhe ekspertët jugosllavë duhej të largoheshin nga Shqipëria. Akuzat kundër J. B. Titos dhe Partisë Komuniste të Jugosllavisë u dëgjuan në kongreset e organizuara në Shqipëri pas pranimit të rezolutës. E gjithë ndihma që u dha nga viti 1945 deri në mesin e vitit 1948 u portretizua si dëshira e autoriteteve jugosllave për të shfrytëzuar burimet natyrore të Shqipërisë, për të devijuar industrinë e saj në dobi të Jugosllavisë dhe për ta kthyer Shqipërinë

115 ADMPJRS, AP, dosja1, 1947, dok.1, 1947, dok.23, sign.19227, Një vështrim mbi gjendjen ekonomike në Shqipëri gjatë shtatorit 1947; AJ, 507/9, 1/1-127-242, Shënime nga raporti.

116 Leonid J. Gibianskii, “Sovjetsko-jugoslovenskisukob 1948: istoriografskeverzijeinoviarhivskizvori”, në *Jugoslavijavhladnivojni*, ed. Jasna Fisher, (Ljubljana: Inštitutzanovejšozgodovino, Toronto: University, 2004), 40–41; *Jugoslovensko-sovjetski odnosi: 1945–1956*, 245; Životić, *Jugoslovensko-sovjetske vojne suprotnosti (1947–1957). Iskušnja savezništva* (Beograd: Arhipelag, Institut za noviju istoriju Srbije, 2015), 161–162.

117 AY, 507/9, 1/ 2-111, Eighth Plenum of the Central Committee of the Communist Party of Albania, March 27, 1948.

118 AJ, 507/9, 1/1-161, Shtypi shqiptar mbi rezolutën e Informbyrosë; Vladimir Adamović, “Enver Hodža: mehanizmi vlasti”, *Ideje: jugoslovenski studentski časopis*, no. 5–6 (1987): 167; Đorđe Borozan, „Paternalistička ponašanja albanskih vlada prema Albancima u Jugoslaviji tokom 20. Vijekā”, *Vojno delo*, no. 2 (1997): 32; Kristo Frasheri, *The History of Albania. A Brief Survey* (Tirana, 1964), 336–337; *Jugoslavija 1918–1988*, 935; Laker, *Istorija Evrope 1945–1992*, 417; Stevan K. Pavlović, *Srbija, istorija iza imena*, (Beograd: Clio, 2004), 206; Pipa, *Albanian Stalinism. Ideo-Political Aspects*, 137–138; Radovan Radonjić, “Jugoslovensko-albanski odnosi u periodu sukoba KPJ sa Kominformom: (1948–1956)”, *Marksistička misao: časopis za teoriju i praksu socijalizma i socijalističkog samoupravljanja*, no. 6 (1985): 166; Mile Veljović, “Kontinuitet i promene u albanskoj politici”, *Međunarodna politika* 38. nr. 885 (1987): 6; Mile Veljović, “Odnosi Jugoslavije i Albanije”, *Međunarodna politika* 37, nr. 874 (1986): 23; Životić, “*Jugoslavija i jačanje sovjetskog uticaja u Albaniji 1947–1948*”, 110–111.

në koloni.¹¹⁹

Shqipëria nënshkroi marrëveshje tregtare me Bullgarinë dhe Bashkimin Sovjetik.¹²⁰ Enver Hoxha shpalli ndarjen përfundimtare me Jugosllavinë dhe kthesën drejt BRSSs në Plenumin e 11-të, të mbajtur nga 13 deri më 24 shtator 1948.¹²¹ Në Kongresin e Parë të Partisë së Punës së Shqipërisë (siç u quajt Partia Komuniste e Shqipërisë), mbajtur nga 8 deri më 22 nëntor 1948,¹²² Enver Hoxha pezulloi çdo marrëdhënie me Jugosllavinë për pesë vitet e ardhshme. Jugosllavia dhe Shqipëria rihapën zyrat e tyre diplomatike në Tiranë dhe Beograd në vitin 1954, por marrëdhëniet midis dy vendeve mbetën të ftohta dhe të rezervuara.¹²³

Përfundime

Shqipëria dhe Jugosllavia kishin krijuar marrëdhënie të mira që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore. Ato u reflektuan në bashkëpunimin ekonomik, politik, kulturor, ushtarak dhe shëndetësor. Shqipëria mori ndihmë ekonomike nga Jugosllavia, veçanërisht në fushën e bujqësisë dhe ndërtimit të hekurudhave dhe fabrikave. Më pas, Shqipëria ngriti do të kopjonte sistemin jugosllav politik. Në atë periudhë mes dy vendeve pati një konflikt me fuqitë perëndimore dhe negociata mes Jugosllavisë dhe Bullgarisë për krijimin e një federate ballkanike, në të cilën do të përfshihej edhe Shqipëria. Jugosllavia kshte marrëdhënie të mira me BRSS-në dhe kishte kopjuar sistemin shtetëror dhe partiak

119 Slavković Mirić, *Jugoslavija i Albanija 1945-1948: Ekonomski odnosi*, 307-319.

120 AJ, 112-840-841, 3 gusht, 1948; AJ, 507/9, 1 / 1-197, *Rude Pravo (E drejta minerare)*, 24 shtator 1948; ADMPJRS, AP, dosja 3, 1948, dok. 4, sign. 420745, Telegram i Kosmrljit dërguar MPJ, 3 gusht 1948; ADMPJRS, AP, dosja 3, 1948, dok. 4, sign. 423750, Telegram i Kosmrljit dërguar MPJ, 7 shtator 1948; ADMPJRS, AP, dosja 3, 1948, dok. 4, sign. 424365, Telegram i Kosmrljit dërguar MPJ, 15 shtator 1948; ADMPJRS, AP, dosja 3, 1948, dok. 12, sign. 424764, Telegram i Kosmrljit dërguar MPJ, 22 shtator 1948.

121 AJ, 507/9, 1/2-111, Rezoluta e Plenumit të 11-të të PKSH.

122 AJ, 507/9, 1/2-119, Kongresi i Parë i PPSH.

123 Vladimir Cvetković, “Diplomatske misije FNRJ u Sofiji, Bukureštu i Tirani 1953–1954: povratak ambasadora, uslovi rada i incidenti”, në *Jugoslovenska diplomatija 1945–1961*, red. Slobodan Selinić, (Beograd: Institut za noviju istoriju Srbije, 2012), 206. Më shumë mbi normalizimin e marrëdhënieve mes Jugosllavisë dhe Shqipërisë dhe vendeve të “demokracive popullore” në vitet 1953-58, shih: Vladimir Cvetković, *Pogled iza gvozdena zavese: jugoslovenska politika prema zemljama narodne demokratije u susedstvu 1953–1958* (Beograd: Institut za noviju istoriju Srbije, 2013).

sovjetik. Stalini ia la Shqipërinë Jugosllavisë, duke besuar se ishte sfera e saj e interesit. Bashkëpunimi ekonomik jugosllavo-shqiptar ishte në rritje, veçanërisht pas vizitës së Enver Hoxhës në Jugosllavi në mesin e vitit 1946 dhe nënshkrimit të Traktatit të Miqësisë, Bashkëpunimit dhe Ndihmës së Ndërsjellë. Megjithatë, Shqipëria shfaqti dëshirë për të vendosur kontakte të drejtpërdrejta me Bashkimin Sovjetik, kështu që shpesh kishte rezerva dhe mosbesim nën lavdërimet për bashkëpunimin me Jugosllavinë. Kriza në marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare ndodhi kur krerët e partive sovjetike dhe shqiptare vendosën bashkëpunim të drejtpërdrejtë, me vizitën e Enver Hoxhës në Moskë në mesin e vitit 1947. Më në fund, pas pranimit të rezolutës së Informbyrosë, Shqipëria u kthye kundër fqinjit të saj, duke mbajtur anën e BRSS-s. Marrëdhëniet mes Jugosllavisë dhe Shqipërisë u normalizuan pas vitit 1955, por mosbesimi dhe distanca mbetën.

Bibliografia:

- Adamović, Vladimir. "Enver Hodža: mehanizmi vlasti", *Ideje: jugoslovenski studentski časopis*, no. 5–6 (1987): 162–171.
- Albania, edited by Stavro Skendi. New York: Frederick A. Praeger, 1958.
- Archives of Yugoslavia, Belgrade, Republic of Serbia, Fund 15 (Presidium of the National Assembly of FНРY); Fund 25 (Ministry of Labor FНРY); Fund 50 (Presidency of the Government of FНРY); Fund 112 (Tanjug news agency); Fund 507/9 (Commission for International Links of the Central Committee of the Association of Communists of Yugoslavia); Fund 836 (Office of the Marshal of Yugoslavia).
- Babić, Milenko. *Enver Hodžina Albanija*. Beograd: Novinska agencija Tanjug, 1981.
- Balkanski ugovorni odnosi: 1876–1996.: dvostrani i višestрани međunarodni ugovori i drugi diplomatski akti o državnim granicama, političkoj i vojnoj saradnji, verskim i etničkim manjinama, II, (1919–1945)*, edited by Momir Stojković. Beograd: Službeni list SRJ: Međunarodna politika, 1998.
- Balkanski ugovorni odnosi: 1876–1996.: dvostrani i višestрани međunarodni ugovori i drugi diplomatski akti o državnim granicama, političkoj i vojnoj saradnji, verskim i etničkim manjinama, III, (1946–1996)*, edited by Momir Stojković. Beograd: Službeni list SRJ: Međunarodna politika, 1999.
- Bartl, Peter. *Albanci: od srednjeg veka do danas*. Beograd: Clio, 2001.
- Bela knjiga o agresivnim postupcima vlada SSSR, Poljske, Čehoslovačke, Mađarske,*

- Rumunije, Bugarske i Albanije prema Jugoslaviji*. Beograd: Ministarstvo inostranih poslova FNRJ, 1951.
- Bela knjiga o neprijateljskoj politici Vlade Narodne Republike Albanije prema Federativnoj Narodnoj Republici Jugoslaviji*. Beograd: Državni sekretarijat za inostrane poslove Federativne Narodne Republike Jugoslavije, 1961.
- Bilandžić, Dušan, and Radovan Vukadinović. *Osnovne društvene promene u Jugoslaviji i svijetu nakon Drugog svjetskog rata 1945–1973*. Zagreb: Školska knjiga, 1973.
- Bilandžić, Dušan. *Borba za samoupravni socijalizam u Jugoslaviji 1945–1969*. Zagreb: Institut za historiju radničkog pokreta Hrvatske, 1969.
- Bilandžić, Dušan. *Društveni razvoj socijalističke Jugoslavije*. Zagreb: Centar društvenih djelatnosti Saveza socijalističke omladine Hrvatske, 1976.
- Bilandžić, Dušan. *Ideje i praksa društvenog razvoja Jugoslavije 1945–1973*. Beograd: Komunist, 1973.
- Bilandžić, Dušan. *Kratak pregled razvitka društveno-ekonomskih odnosa u SFRJ 1945–1965*. Beograd: Centar za ideološko-političko obrazovanje Radničkog univerziteta "Đuro Salaj", 1965.
- Bjelajac, Mile, and Gordana Krivokapić-Jović. *Prilozi iz naučne kritike – Srpska historiografija i svet (uticaj jugoslovenske krize na stranu i domaću historiografiju)*. Beograd: Institut za noviju istoriju Srbije, 2011.
- Boffa, Giuseppe. *Povijest Sovjetskog Saveza, II: Od domovinskog rata do položaja druge velesile: Staljin i Hruščov: 1941–1964*. Opatija: "Otokar Keršovani", 1985.
- Bogetić, Dragan. "Jugoslavija između Istoka i Zapada". In *Jugoslavija u Hladnom ratu*, edited by Aleksandar Životić, 13-36. Beograd: Institut za noviju istoriju Srbije, 2010.
- Bondžić, Dragomir. *Beogradski univerzitet 1944–1952*. Beograd: Institut za savremenu istoriju, 2004;
- Bondžić, Dragomir. *Misao bez pasoša: međunarodna saradnja Beogradskog univerziteta 1945–1960*. Beograd: Institut za savremenu istoriju, 2011.
- Borožan, Djordje. "Paternalistička ponašanja albanskih vlada prema Albancima u Jugoslaviji tokom 20. vijeka", *Vojno delo*, no. 2 (1997): 28-40.
- Borožan, Đorđe, "Jugoslavija i Albanija. Prva poratna iskustva". In *Balkan posle Drugog svetskog rata*, edited by Petar Kačavenda, 287-306. Beograd: Institut za savremenu istoriju, 1996.
- Cvetković, Slavoljub, "Pokušaji stvaranja balkanske federacije 1944–1948". In *Balkan posle Drugog svetskog rata*, edited by Petar Kačavenda, 46–51. Beograd: Institut za savremenu istoriju, 1996.
- Cvetković, Vladimir. "Diplomatske misije FNRJ u Sofiji, Bukureštu i Tirani 1953–1954: povratak ambasadora, uslovi rada i incidenti". In *Jugoslovenska diplomatija 1945–1961*. edited by Slobodan Selinić. 205-220. Beograd: Institut za noviju istoriju Srbije, 2012.
- Cvetković, Vladimir. *Pogled iza gvozdene zavese: jugoslovenska politika prema*

- zemljama narodne demokratije u susedstvu 1953–1958*. Beograd: Institut za noviju istoriju Srbije, 2013.
- Dedijer, Vladimir. *Jugoslovensko-albanski odnosi: 1939–1948*. Beograd: Borba, 1949.
- Dibra, Pranvera. "Economic Agreements in the Yugoslav-Albanian Relations". *Mediterranean Journal of Social Sciences* no 13, vol 5 (2014), 289-293 (Doi:10.5901/mjss.2014.v5n13p289, accessed April 5, 2022).
- Đilas, Milovan**. *Druženje sa Titom*. Šabac: Zaslón, 1990.
- Đilas, Milovan**. *Heroj-antiheroj. Iskazi za istoriju*. Podgorica: Pobjeda, 2006.
- Đilas, Milovan**. *Razgovori sa Staljinom*. Beograd: Književne novine, 1990.
- Đilas, Milovan**. *Vlast i pobuna: memoari*. Zagreb: Europapress, Novi liber, 2009.
- Đilas, Milovan**. *Vlast*. London: Naša reč, 1983.
- Dimić, Ljubodrag. *Agitprop kultura. Agitpropovska faza kulturne politike u Srbiji 1945–1952*. Beograd: Rad, 1988.
- Dimić, Ljubodrag. *Istorija srpske državnosti. Srbija u Jugoslaviji*, III. Novi Sad: Srpska akademija nauka i umetnosti, 2001.
- Dimić, Ljubodrag. *Josip Tito – Josif Staljin*. Beograd: Arhiv Srbije i Crne Gore, 2006.
- Dimitrijević, Bojan. "Jugoslovensko-sovjetski vojni odnosi 1945–1948". *Istorija* 20. veka. no. 1(1997): 87–96.
- Dimitrijević, Bojan. "Odnosi jugoslovenske armije i balkanskih armija 1945–1951". In *Balkan posle Drugog svetskog rata*, edited by Petar Kačavenda, 374–388. Beograd: Institut za savremenu istoriju, 1996.
- Diplomatic Archives of the Ministry of Foreign Affairs of the Republic of Serbia, Belgrade, Republic of Serbia, Political Archive, 1945-1948, Albania.
- Dizdarević, Nijaz. *Albanski dnevnik*. Zagreb: Globus, Sarajevo: Oslobođenje, 1988.
- Dobrivojević, Ivana. *Selo i grad. Transformacija agrarnog društva Srbije 1945–1955*. Beograd: Institut za savremenu istoriju, 2013.
- Ekspoze Maršala Tita o spoljnoj politici Jugoslavije: održan na zajedničkoj sednici Savezne skupštine i Skupštine naroda 1 aprila 1946*. Beograd, Zagreb: Kultura, 1946.
- Fevziu, Blendi. *Enver Hodža: prva biografija zasnovana na dokumenti od ličnata arhiva i na ispovedite na onie što go poznavaa*. Skopje: Fondacija Otvoreno opštество - Makedonija, 2014.
- Fraseri, Kristo. *The History of Albania. A Brief Survey*. Tirana: na, 1964.
- Gaćeša, Nikola L. "Privredni odnosi Jugoslavije i Albanije 1945–1948". *Zbornik Matice srpske za istoriju*, no. 42 (1990): 87–127.
- Gaddis, John Lewis. *Hladni rat. Mi sada znamo*. Beograd: Clio, 2003.
- Geler, Mihail, and Aleksandr Nekrič. *Utopija na vlasti. Istorija Sovjetskog saveza*. Podgorica: Cid, 2000.
- Gibianskii, Leonid J. "Sovjetsko-jugoslovenski sukob 1948: istoriografske verzije i novi arhivski izvori". In *Jugoslavija v hladni vojni*, edited by Jasna Fisher, 27-47. Ljubljana: Inštitut za novejšo zgodovino, Toronto: University, 2004.
- Histoire de l'Albanie: des origines à nos jours*, edited by Stefanaq Pollo and Arben Puto. Roanne: Editions Horvath, 1974.
- Hodža, Enver. *Titoisti*. Tirana: Izdavačka kuća "8 nentori", 1982.

- Hoxha, Enver. *Rapport d'activité du Comité central du Parti du travail d'Albanie: présenté au VIIIe Congrès du PTA le 1er novembre 1981*. Tirana: Editions "8 Nëntori", 1981.
- Hoxha, Enver. *The Anglo-American Threat to Albania: Memoirs of the National Liberation War*. Tirana: 8. Nëntori, 1982.
- Hoxha, Enver. *Avec Staline: souvenirs*. Tirana: 8. Nëntori, 1979.
- Hrabak, Bogumil. "Međunarodni položaj Albanije 1945–1947. i Jugoslavija". *Istraživanja* no.13 (1990): 249–312.
- Hronologija revolucionarne delatnosti Josipa Broza Tita*, edited by Branislav Ilić and Vojislav Ćirković. Beograd: Export-press, 1978.
- Jugoslavija 1918–1988: statistički godišnjak*. Beograd: Savezni zavod za statistiku, 1989.
- Jugoslavija 1918–1988. Tematska zbirka dokumenata*, edited by Branko Petranović and Momčilo Zečević. Beograd: Rad, 1988.
- Jugoslavija–SSSR. Susreti i razgovori na najvišem nivou rukovodilaca Jugoslavije i SSSR 1946–1964, tom 1*, edited by Lj. Dimić, L. A. Veličanskaja, T. A. Džalilov et al. Beograd: Arhiv Jugoslavije, 2014.
- Jugoslovensko-sovjetski odnosi: 1945–1956*, edited by Ljubodrag Dimić et al. Beograd: Ministarstvo spoljnih poslova, 2010.
- Kamberović, Husnija. "Prilog proučavanju odnosa između Jugoslavije i Albanije od 1945 do 1948". *Glasnik Arhiva i Društva arhivskih radnika Bosne i Hercegovine = Mitteilungen der Archive und des Vereins der Archivare von Bosnien und Herzegovina*, no. 31(1991): 185–201.
- Kardelj, Edvard. *Borba za priznanje i nezavisnost nove Jugoslavije: 1944.–1957 (sećanja)*. Beograd: Radnička štampa, Ljubljana: Državna založba Slovenije, 1980.
- Kidrič, Boris. *Izgradnja socijalističke ekonomike FNRJ, III*. Beograd: Kultura, 1960.
- Kidrič, Boris. *Podaci reparacione komisije potvrđuju nepravdu koja se čini Jugoslaviji u pogledu reparacija, III*. Beograd: Komunist, 1960.
- Komatina, Milorad. *Enver Hodža i jugoslovensko-albanski odnosi*. Beograd: Službeni list, 1995.
- Krempton, Ričard. *Balkan posle Drugog svetskog rata*. Beograd: Clio, 2003.
- Laker, Volter. *Istorija Evrope 1945–1992*. Beograd: Clio, 1999;
- Lydall, Harold. *Yugoslav Socialism: Theory and Practice*. Oxford: Clarendon Press, 1984.
- Marmullaku, Ramadan. *Albania and the Albanians*. London: C. Hurst and Co, 1975.
- Materijalni i društveni razvoj SFR Jugoslavije 1947–1972: Deseti kongres SKJ*. Beograd: Savezni zavod za statistiku, 1973.
- Mates, Leo. *Međunarodni odnosi socijalističke Jugoslavije*. Beograd: Nolit, 1976.
- Mëhilli, Elidor. *From Stalin to Mao: Albania and the Socialist World*. Cornell University Press, 2017.

- Мете, Серж. *История на Албанците: от илирите до независимостта на Косово*. Софија: Рива, 2007.
- Milak, Enes. "Spoljnotrgovinski odnosi Jugoslavije 1945–1948". In *Balkan posle Drugog svetskog rata*, edited by Petar Kačavenda, 175–181. Beograd: Institut za savremenu istoriju, 1996.
- Miletić, Aleksandar V. *Prelomna vremena: Milovan Djilas i zapadnoevropska socijalistička i socijaldemokratska levica: 1950-1954*. Beograd: Institut za noviju istoriju Srbije, 2019.
- Miletić, Aleksandar V. *Titov emisar Milovan Djilas: diplomatsko-pregovaračke i spoljnopolitičke aktivnosti (1943-1953)*. Beograd: Institut za noviju istoriju Srbije, 2021.
- Mugoša, Dušan. *Na zadatku*. Beograd: Četvrti jul, 1975.
- Napukli monolit. Jugoslavija i svet 1942–1948*, edited by Ljubodrag Dimić and Aleksandar Životić. Beograd: Arhipelag, Službeni glasnik, 2012.
- Nikolić, Kosta. *Srbija u Titovoj Jugoslaviji (1941–1980)*. Beograd: Zavod za udžbenike, 2011.
- Nikolić, Miodrag, and Bogdan Vidaković. *Regionalni razvoj proizvodnih snaga Jugoslavije u politici SKJ od Petog kongresa KPJ do Desetog kongresa SKJ*. Beograd: Savremena administracija, 1977.
- Obradović, Marija, "Narodna demokratija" u Jugoslaviji 1945–1952. Beograd: INIS, 1995.
- Pavlović, Momčilo. "Albanija između Tita i Staljina". In *Balkan posle Drugog svetskog rata*, edited by Petar Kačavenda, 306–315. Beograd: Institut za savremenu istoriju, 1996;
- Pavlović, Momčilo. *Srpsko selo 1945–1952. Otkup*. Beograd: Institut za savremenu istoriju, 1997.
- Pavlović, Stevan K. *Srbija, istorija iza imena*. Beograd: Clio, 2004.
- Pejović, Marko. "Sovjetski filmovi prikazani u Jugoslaviji 1945–1948. u organizaciji Društva za kulturnu saradnju Jugoslavije sa SSSR-om", *Godišnjak za društvenu istoriju*, no. 1 (2010): 89–103.
- Perazić, Gavro. "Jugoslovensko-albanski odnosi u odnosu na teritorijalni integritet", *Ideje* no. 5–6 (1987): 91-97.
- Perović, Marko. *Ekonomski odnosi Jugoslavije i Albanije: 1947–1948*. Beograd: Savez novinara Jugoslavije, 1951.
- Petranović, Branko, and Momčilo Zečević. *Jugoslovenski federalizam – ideje i stvarnost II: 1943–1986*. Beograd: Prosveta, 1987.
- Petranović, Branko. *Balkanska federacija 1943–1948*. Šabac: Zaslona, 1991.
- Petranović, Branko. *Istorija Jugoslavije 1918–1988, III*. Beograd: Nolit, 1988.
- Petranović, Branko. *Jugoslavija, velike sile i balkanske zemlje 1945–1948: Iskustvo „narodne demokratije“ kao partijske države*. Beograd, Podgorica: Istorijski institut Crne Gore, 1994.

- Pipa, Arshi. *Albanian Stalinism. Ideo-Political Aspects*. New York: Columbia university press, 1990.
- Pljaku, Panajot. *Nasilje nad albanskom revolucijom*. Beograd: Narodna knjiga, Priština: Rilindija, Jedinstvo, 1984.
- Pregled istorije Saveza komunista Jugoslavije*. Beograd: Institut za izučavanje radničkog pokreta, 1963.
- Prifti, Peter. *Socialist Albania since 1944. Domestic and Foreign Developments*. Cambridge Mass. [etc.]: MIT Press, cop. 1978.
- Radovan Radonjić, "Jugoslovensko-albanski odnosi u periodu sukoba KPJ sa Kominformom: (1948–1956)", *Marksistička misao: časopis za teoriju i praksu socijalizma i socijalističkog samopupravljanja*, no. 6 (1985): 160-174.
- Rafailović, Jelena. *Razvoj industrije na Balkanu. Tekstilna industrija u Kraljevini Srba, Hrvata i Slovenaca i Bugarskoj 1919–1929*. Beograd: Institut za noviju istoriju Srbije, 2018.
- Selinić, Slobodan, and Dušan Bajagić. *Jugoslavija i svet 1945–1950. Hronologija*. Beograd: Institut za noviju istoriju Srbije, 2010.
- Selinić, Slobodan. "Jugoslavija, SSSR i istočnoevropske zemlje 1944–1948". In *Oslobođenje Beograda 1944*, edited by Aleksandar Životić. 393-418. Beograd: Institut za noviju istoriju Srbije, 2014.
- Shameti, Ornella. "Albanian-Yugoslav Relations in the International Optics", *Academic Journal of Business, Administration, Law and Social Sciences*, no 1, vol 6 (2020), 119-124 (<https://iipcccl.org/wp-content/uploads/2020/03/119-124.pdf> accessed April 5, 2022)
- Slavković Mirić, Božica. "Pogranični promet Jugoslavije i Albanije i dvovlasnička imanja 1945-1948", *Istorija 20. veka*, no. 1 (2020): 107-128.
- Smodlaka, Josip. *Partizanski dnevnik*. Zagreb: Spektar, 1986.
- Suljagić, Boris. "Odnos jugoslovenskoga i albanskog komunističkog vrha od kraja Drugog svjetskog rata do prekida odnosa (1945-1948)", *Časopis za suvremenu povjest* 1/2019, 213-231.
- Swain, Geoffrey, and Nigel Swain, *Eastern Europe since 1945*. Houndmills [etc.]: Macmillan, 1993.
- Tripković, Đoko. "Spoljni faktori i politička kretanja u Jugoslaviji 1945–1955", *Istorija 20. veka*, no. 2 (1995): 77-90.
- Veljović, Mile. "Kontinuitet i promene u albanskoj politici", *Međunarodna politika* 38, no. 885 (1987): 4-6.
- Veljović, Mile. "Odnosi Jugoslavije i Albanije", *Međunarodna politika* 37, no. 874 (1986): 23-26.
- Vukmanović Tempo, Svetozar. *Revolucija koja teče. II*. Zagreb: Globus, 1982.
- Vukmanović-Tempo, Svetozar. *Zašto se i kako raspala Jugoslavija*. Beograd: Službeni list SRJ, 1996.
- Zakon o petogodišnjem planu razvojnog narodne privrede Federativne Narodne Republike Jugoslavije: u godinama 1947–1951*. Beograd: Službeni list FNRJ, 1947.

- Zapisnici sa sednica Politbiroa CK KPJ (11. jun 1945 – 7. jul 1948)*, edited by Branko Petranović. Beograd: Arhiv Jugoslavije, Službeni list SRJ, 1995.
- Živković, Nikola.** "Stanje u jugoslovenskoj privredi neposredno po završetku Drugog svetskog rata". In *Balkan posle Drugog svetskog rata*, edited by Petar Kačavenda, 51–55. Beograd: Institut za savremenu istoriju, 1996.
- Životić, Aleksandar.** "Jugoslavija i jačanje sovjetskog uticaja u Albaniji 1947–1948". *Tokovi istorije*, no. 3 (2009): 94–116.
- Životić, Aleksandar.** "Pitanje Albanije u odnosima Jugoslavije i Zapada 1945–1947", *Istorija 20. veka*, no. 3 (2010): 83-96.
- Životić, Aleksandar.** *Jugoslavija, Albanija i velike sile 1945–1961*. Beograd: Arhipelag, Institut za noviju istoriju Srbije, 2011.
- Životić, Aleksandar.** *Jugoslovensko-sovjetske vojne suprotnosti (1947–1957). Iskušenja savezništva*. Beograd: Arhipelag, Institut za noviju istoriju Srbije, 2015
- Zlatar, Pero. *Enver Hodža: politička biografija*. Beograd: Rad, 1986.